



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATE /A	10.12.2024
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan z. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës – Muaji NËNTOR 01.11.2024-29.11.2024

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajit Nëntor, DKA ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme brenda kompetencave të veta.

Është mbajtur takimi I komisionit për vlerësimin e femijëve me nevoja te veqanta në shkollat "Vëllezërit Domaneku" në Topliqan është vlerësuar 1(një) dhe "Nezë Bujani" në Bujan ku janë vlerësuar 3 (tre) fëmijë.

Kemi bërë kërkesë në prokurim për furnizimin e shkollës,,17 Shkurti” Glllogovc me antifriz për ngrohje qendrore.

Në shkollën SHFMU” Shtjefën Gjeqovi” Janjevë paralelja e ndarë fizike në Brus është bërë intervenimi për ndarjen e klasave ku edhe shkolla ka kaluar më mësim në një ndërrim.

Me datë 09.11.2024, është mbajtur gara e Olimpiadës Matematike të Kosovës për nivelin Komunal.

Kanë marrë pjesë nxënës nga klasa e 7-të deri në klasën e 12-të të shkollave publike dhe private. Në garat e nivelit qendror janë kualifikuar 15 nxënës.

Më datë 16.11.2024 janë mbajtur garat ndërkombëtare nga lëndët Gjeografi, Histori, Gjuhë Angleze dhe Gjuhë Shqipe në Shqipëri, të cilat janë prezantuar me 4 projekte , që janë kualifikuar për finale. Në këto gara kanë marrë pjesë 45 nxënës, ku 2 nxënës kanë zënë vendin e parë dhe 4 nxënës vendin e dytë.

Me datë 22.11.2024 është mbajtur punëtorja e grupeve fituese Upshift, ku 51 pjesëmarrësit kanë mësuar rreth zgjidhjes së problemeve që I shqetësojnë dhe kanë ofruar zgjidhje praktike. Grupet fituese të upshift janë; Eco group, Equal voices equal choices, Klubi I gjelbërt, Workshop of youth dhe Equality.

Me datë 23 dhe 24 nëntor janë mbajtur punëtorja me mësimdhënësit e shkollave për rishikimin e teksteve shkollore.

Në bashkëpunim me SBASHK-un janë duke u realizuar trajnime të mësimdhënësve në fushën e teknologjisë informative.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime-kthimi nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit, shtimi i përvojës,
- Formular për largim-skadim kontrate, pensionimi,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme-ndërrimi i xhirollogarisë.

Nënalokimi i mjeteve në të gjitha kategoritë:

- a). Paga&meditje
- b). Mallra&komunali
- c). Komunali

Zotimet në kategorinë mallra & shërbime dhe komunali.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.

